



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 208 Prot

Tiranë, më 27/1 /2021

REKOMANDIM

Nr. 18, datë 27/1 /2021

PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS
SË AUTORITETIT PUBLIK “BASHKIA DELVINË”

Në mbështetje të neneve 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”), Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka kryer monitorimin on-line në faqen zyrtare:

(<https://www.bashkiadelvine.gov.al/programi-i-transparences/>)

të Autoritetit Publik “Bashkia Delvinë” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Bazuar në nenin 4 të LDI, Autoriteti Publik ka detyrimin të vendosë në zbatim programin institucional të transparencës, sipas Urdhrit nr. 211, datë 10.09.2018 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore” të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë.

Ky program, vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet përditësimit dhe pasurimit të vazhdueshëm të tij, në referencë edhe të pikës 2 të nenit 5 të LDI.

Në lidhje me monitorimin e kryer, nga Drejtoria për të Drejtën e Informimit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri"), konstaton se Autoriteti Publik, në menunë kryesore të faqes zyrtare ka të publikuar ikonwn "Programi i Transparencës" në të cilën është vendosur dokumenti i programit të transparencës, në përputhje me modelin e miratuar me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore" të Komisionerit. Ky dokument është i plotësuar pjesërisht me informacionin e nevojshëm dhe nuk është i ndërlidhur me faqen zyrtare të Autoritetit Publik në ato raste kur ky informacion gjendet i publikuar. Një pjesë e informacionit të publikuar gjenden në nën menunë "Programi i Transparencës" dhe një pjesë tjetër në faqen kryesore të Autoritetit Publik. Gjithashtu kanë mbetur pa u publikuar një pjesë e mirë kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pavarësisht se një pjesë e informacionit publik pa kërkesë është publikuar në faqen zyrtare, Autoriteti Publik duhet t'i përmbahet programit model të transparencës të miratuar nga Komisioneri me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore", sipas gjetjeve të pasqyruara në lidhjen nr. 1 të këtij rekomandimi.

Detyrimi për bërjen transparente të veprimtarisë së tyre, njërive të vetëqeverisjes vendore i'u lind gjithashtu edhe në zbatim të Kreut VI, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar. Konkretisht në nenin 15 të ligjit të sipërcituar "Transparenca e veprimtarisë së njërive të vetëqeverisjes vendore", parashikohet se: "1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre. 2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike...".

Në mbështetje të neneve 6 dhe 7 të LDI dhe shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, nga monitorimi i kryer,

REKOMANDOJ :

1. Autoriteti Publik/Bashkia Delvinë të pasqyrojë/ndërlidhë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publike në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore" të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas lidhjes nr. 1 të këtij rekomandimi.
2. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara

në pikën 1 të këtij rekomandimi, brenda një afati 90 (nëntëdhjetë) ditor nga momenti i marrjes dijeni.

3. Në rast mospërbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 18, 19 dhe 20 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë __.__.2021

KOMISIONERI

Besnik Dervishi




Lidhja nr.1

Raport i monitorimit për zbatimin të programit institucional të transparencës, bazuar në Urdhrin nr. 211, dt.10.09.2018 "Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore" të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për Bashkinë Delvinë.

Janar 2021

Programi i Transparencës është i miratuar dhe i publikuar në faqen kryesore të Autoritetit Publik. Informacioni është i publikuar pjesërisht, por nuk është i ndërlidhur me faqen zyrtare të institucionit.



[\(https://www.bashkiadelvine.gov.al/programi-i-transparences/\)](https://www.bashkiadelvine.gov.al/programi-i-transparences/)

1. Organizimi dhe funksionimi i bashkisë

1.1 Organizimi administrativo-territorial, misioni dhe funksionet

1.1.1 Ndarja administrative territoriale


- Njësitë administrative dhe nën-ndarjet e tyre



Informacioni i publikuar është i pjesshëm dhe nuk është i ndërlidhur me Programin e Transparencës.

1.3 Organi përfaqësues i Bashkisë - Këshilli bashkiak (procesi i vendimmarrjes). Përfshin bërjen publike të:

- Kalendarit të mbledhjeve të KB
- Njoftimet për mbledhjen e KB
- Rendin e ditës së mbledhjes së KB
- Projekt-vendimet në proces shqyrtimi nga KB
- Procesverbalet e mbledhjeve të KB
- Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ



Informacioni është i publikuar pjesërisht dhe nuk është i ndërlidhur me Programin e Transparencës, por ndodhet në menunë e AP, Vendimet e KB gjenden të publikuara në



Informacioni i publikuar në Programin e Transparencës është i pjesshëm dhe nuk është i ndërlidhur me faqen kryesore të Autoritetit Publik.

1.6 Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit

- Karta e auditimit të brendshëm
- Kodi i etikës për audituesit e brendshëm
- Plani strategjik dhe vjetor i njësisë së auditimit
- Raportet e auditimit të brendshëm të ushtruar në bashki
- Cdo raport përfundimtar të kontrollit të jashtëm (KLSH) të ushtruar në bashki
- Planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm

Informacioni nuk është i publikuar në Programin e Transparencës.

1.7 Kërkesa, ankesa, sinjalizime dhe vërejtje që lidhen me

- Procedura për të bërë kërkesë ankesë, vërejtje dhe sinjalizime organeve të bashkisë
- Rregullore e brendshme për procedurën e shqyrtimit, hetimit administrativ, sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit
- Njësinë përgjegjëse që regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet
- Adresa postare/elektronike për depozitimin e kërkesave, ankesave, sinjalizimeve dhe vërejtjeve

- Afatet dhe mënyrat e kthimit të përgjigjeve në lidhje me kërkesat, ankesat, vërejtjet

Informacioni nuk është i publikuar në Programin e Transparencës.

1.8 Statistikat vendore Kalendar i publikimit të statistikave

- Statistika vendore me të dhëna kyce të bashkisë sipas fushave kryesore dhe të ndara sipas gjinisë
- Strukturën përgjegjëse në bashki për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave

Informacioni nuk është i publikuar në Programin e Transparencës dhe as në faqen zyrtare të Autoritetit Publik.

2. Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko – financiare:

2.1 Kalendar i programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor

2.2 Paketa fiskale (taksa dhe tarifa). Përfshin bërjen publike të:

- Baza e taksave dhe e tarifave
- Niveli i taksave
- Përjashtime dhe lehtësime të subjekteve të caktuara
- Afatet e pagesave
- Gjoha dhe kamatvonesa të aplikueshme



Informacioni është i publikuar pjesërisht në Programin e Transparencës.

2.3 Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë

- Politikat për zhvillimin e qëndrueshëm në një afat kohor jo më pak se 5 vite
- Synimet kryesore për çdo fushë përgjegjëse

- Veprimet që duhen ndërmarrë duke parashikuar edhe kostot përkatëse
- Burimet e financimit

Informacioni nuk është i publikuar në Programin e Transparencës dhe as në faqen zyrtare të Autoritetit Publik.


2.4 Programi Buxhetor Afatmesëm vendor. Përfshin bërjen publike të:

- Dokumenti i parë i PBA-së
- Dokumenti i rishikuar i PBA-së
- Dokumenti i plotë i PBA-së

Informacioni nuk është i publikuar në Programin e Transparencës dhe as në faqen zyrtare të Autoritetit Publik.

2.5 Buxheti Përfshin bërjen publike të:

- Buxheti vjetor së bashku me dokumentacionin shoqërues (12 dokumente)
- Treguesit financiarë
- Numri i punonjësve buxhetor për çdo njësi shpenzuese
- Regjistri i parashikimeve të prokurimit public



Informacioni është i publikuar pjesërisht në Programin e Transparencës. Gjendet i publikuar Buxheti për vitin 2020, mungon informacioni për buxhetin për vitet e mëparshme.

2.6 Zbatimi i buxhetit

- Raporti mujor (pas datës 30 pill të cdo viti buxhetor) të përmbledhur mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve (8 raporte)

Informacioni nuk është i publikuar në Programin e Transparencës dhe as në faqen zyrtare të Autoritetit Publik.

2.7 Monitorimi dhe mbikëqyrja e buxhetit

- Raporte të monitorimit të zbatimit të buxhetit (jo më pak se tre raporte 4-mujore)
- Raporti vjetori i konsoliduar i zbatimit të buxhetit (raporti i performancës vjetore dhe pasqyra financiare vjetore)
- Raportit të performancës vjetore
- Pasqyrave financiare vjetore (dokumentacionin bazë dhe shoqërues)
- Informacioni mbi zbatimin dhe monitorimin e kontratave (punë publike, mallra, shërbime)
- Regjistri i realizimeve të procedurave të prokurimit public

Informacioni nuk është i publikuar në Programin e Transparencës dhe as në faqen zyrtare të Autoritetit Publik.

2.8 Vështirësitë Financiare

- Plani për daljen nga situata e vështirë financiare

Informacioni nuk është i publikuar në Programin e Transparencës dhe as në faqen zyrtare të Autoritetit Publik.

2.9 Shitja ose dhënia me qera e pronave dhe asetëve

- Asete dhe prona të ofruara për shitje ose dhënie me qera
- Kriteret që duhen plotësuar

Informacioni nuk është i publikuar në Programin e Transparencës dhe as në faqen zyrtare të Autoritetit Publik.

2.10 Donacione

- Emri i donatorit
- Shuma e donacionit
- Qëllimi i donacionit

Informacioni nuk është i publikuar në Programin e Transparencës dhe as në faqen zyrtare të Autoritetit Publik.

3. Për kërkesat për informacion

3.1 Të dhënat e koordinatorit për të drejtën e Informimit (Emër, kontaktet dhe kompetencat). Përfshin bërjen publike të:

- Emrit mbiemrit të Koordinatorit
- Adresa postare / elektronike
- Detyra dhe kompetenca
- Orari punës

- Adrese postare / elektronike për depozitimin e kërkesave



3.2 Standarde dhe procedura që duhen ndjekur për të bërë kërkesë për informim dhe ankesës. Përfshin bërjen publike të:

- Procedurës që duhet ndjekur për të bërë një kërkesë për informacion
- Adresë postare / elektronike për dërgimin e kërkesës për informim
- Modeli standard i kërkesës
- Afatet për marrjen e përgjigjes
- Procedura që duhet ndjekur për të bërë një ankesë për mos dhënie informacioni
- Adresë postare / elektronike për dërgimin e ankesës për mos dhënie informacion

3.3 Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve. Përfshin bërjen publike të

- Të gjitha kërkesat për informim
- Informacionet e dhëna në përgjigje të kërkesave për informim
- Përditësimi i regjistrit

3.4 Informacion i dhënë më parë

3.5 Trajtimi i kërkesave për informacion

- Procedura e regjistrimit të kërkesës në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve
- Afatet e trajtimit të kërkesës nga ana e administratës së bashkisë
- Mënyrat e dhënies së informacionit

3.6 Kufizimi i së drejtës së informimit

- Rastet e kufizimit të së drejtës për informim

3.7 Tarifa për dhënien e informacionit nëse ka

- Niveli i tarifës
- Rregulla për mënyrën e kryerjes së pagesës

- Subjekte që përftojnë informacione falas

3.8 Informacionet dhe dokumentet që kërkohen shpesh

- Gjithë informacioneve dhe dokumenteve të kërkuara më shpesh nga publiku me kërkesë për informim"

Informacioni i publikuar është shumë i pjesshëm, gjenden vetëm të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit të vendosur në fund të faqes zyrtare të Autoritetit Publik. Informacioni nuk është i ndërlidhur me Programin e Transparenës, gjithashtu mungon i publikuar "Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve", si dhe çdo informacioni/dokumentacioni tjetër sipas të të gjitha pikave të këtij seksioni të Programit të Transparenës.

4. Mbi shërbimet që ofron bashkia

4.1 Shërbimet Përfshin bërjen publike të shërbimeve publike që ofron Bashkia sipas fushave të përcaktuara ligji 139/2015

- "Shërbimet në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike"
- "Shërbimet në fushën e shërbimeve sociale"
- "Shërbimet në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese"
- Shërbimet në fushën e mbrojtjes së mjedisit
- "Shërbimet në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit"
- "Shërbimet në fushën e zhvillimit ekonomik vendor"
- "Shërbimet në fushën e sigurisë publike"
- "Shërbimet në fushën e funksioneve dhe kompetencave të deleguara"

Për cdo shërbim (por pa u kufizuar) informacion përshkruet mbi:

- Instrument për administrimin e shërbimit
- Sistemin e administratës të performancës së shërbimit bazuar mbi standardet
- Sistemin e treguesve, përfshirë edhe aspektin gjinor për matjen e performancës
- Strukturën përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës së shërbimit, përfshirë edhe aspektin gjinor

4.2 Shërbimet administrative Përfshin bërjen publike të shërbimeve publike që ofron Bashkia sipas fushave të përcaktuara ligji 139/2015

- Shërbimet administrative në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike
- Shërbimet administrative në fushën e shërbimeve sociale
- Shërbimet administrative në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese
- Shërbimet administrative në fushën e mbrojtjes së mjedisit

- Shërbimet administrative në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave
- publike, natyrës dhe biodiversitetit
- Shërbimet administrative t në fushën e zhvillimit ekonomik vendor
- Shërbimet administrative në fushën e sigurisë publike
- Shërbimet administrative në fushën e funksioneve dhe kompetencave të deleguara

Për cdo shërbim (por pa u kufizuar) informacion përshkrues mbi


- Strukturat përgjegjëse për ofrimin e shërbimit;
- adresën postare/elektronike të strukturave/njësive/sportelevë që ofrojnë shërbime administrative;
- procedurat që duhen ndjekur për të përfituar shërbime administrative;
- Oraret e punës së strukturave/njësive/sportelevë që ofrojnë shërbime administrative;
- Tarifat për shërbimet administrative;
- Rregullat për mënyrën e kryerjes së pagesës;
- Subjektet që përjashtohen nga tarifat"

4.3 Kontratat publike përfshin bërjen publike të:

- Objektivitet të kontratës publike
- Numrit të referencës së procedurës/ kontratës
- Llojit të procedurës
- Termave dhe kushteve të kontratës
- Kohëzgjatjes së kontratës
- Vlerës së kontratës
- Dhënave të autoritetit kontraktor
- Dhënave të kontraktorit/nëkontraktorit
- Treguesve për matjen e përmbushjes së kontratës
- Strukturave publike përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratës
- Procedurave që duhet ndjekur për të bërë një ankimim
- Raporteve të kontrollit, monitorimit dhe auditimit mbi zbatimin e kontratës

4.4 E drejta e ankesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet

- Procedurave për të bërë ankesa apo vërejtje në lidhje me shërbimet
- Adresës postare/elektronike për depozitimin e ankesave apo vërejtjeve




Mungon plotësisht informacioni në këtë seksion të Programit të Transparencës.

5. Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore. I organizuar (jo i detyrueshëm) sipas fushave:

- Fusha e organizimit dhe funksionimit të bashkisë;
- Fusha e veprimtarisë ekonomiko-financiare;
- Fusha e transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare;
- Fusha e infrastrukturës dhe shërbimeve publike;
- Fusha e shërbimeve sociale;
- Fusha e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese;
- Fusha e mbrojtjes së mjedisit;
- Fusha e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit;
- Fusha e zhvillimit ekonomik vendor;
- Fusha e sigurisë publike;
- Fusha e funksioneve dhe kompetencave të deleguara.

Cdo fushë duhet të përmbajë:

- Aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse;
- dokumentet politike kombëtare përkatëse;
- Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e këshillit të bashkisë me karakter normativ;
- Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e kryetarit të bashkisë me karakter normativ;
- Dokumentet politike vendore



Informacioni është i publikuar në faqen zyrtare të Autoritet Publik, por nuk është i ndërlidhur me Programin e Transparencës.

6. Pjesëmarrja qytetare në vendim-marrje

6.1 Të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik

- Emër mbiemër të koordinatorit
- Adresën postare/ elektronike të tij
- Orarin e punës

6.2 Plani vjetor për procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje"

- Aktet që do të konsultohen
- Mënyra e konsultimit
- Afatet
- Strukturat përgjegjëse

6.3 Dispozitat e brendshme rregullatore për këshillimin me publikun. Përfshin bërjen publike

- Procedurave, afateve dhe mënyrat e organizimit për çdo formë/lloj konsultimi
- Strukturat përgjegjëse për aktet e detyrueshme për konsultim

6.4 Akte për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik. Përfshin bërjen publike të

- Listës së akteve për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik

6.5 Njoftimi për nismën vendimmarrëse me pjesëmarrje

- Projektaktit, relacionin shpjegues dhe dokumentave shoqërues të tij.
- Arsyeve të nevojshme për nxjerrjen e projektaktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë
- Afatit, vendit dhe mënyrën me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre"
- Adresën e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të bashkisë ose të strukturës përgjegjëse për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin
- Vendin dhe datën e organizimit të takimit publik në rastet kur bashkia vendos për organizimin e tij

6.6 Procedura e marrjes dhe shqyrtimit të komenteve dhe rekomandimeve

- Adresën postare/ elektronike për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve"
- Afatin për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve
- Mënyrën e mbajtjes së procesverbalit dhe regjistrimit të takimit publik për takimet publike
- Mënyrën e trajtimit të komenteve dhe rekomandimeve
- Mënyrën e dhënies së arsyeve për mospranimin komenteve dhe rekomandimeve

6.7 Procedurat që duhen ndjekur për të bërë një ankim në lidhje me konsultimin publik. Përfshin bërjen publike të


- Subjektet ku mund të bëhet ankesa (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Këshilli i bashkisë, Kryetari i bashkisë)
- Adresën postare/ elektronike për dërgimin e ankesës
- Procedurat për të bërë një ankesë në lidhje me këshillimin me publikun
- Struktura përgjegjëse në nivel bashkie që regjistron dhe shqyrton ankesën

6.8 Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes.

- Numrit të akteve të miratuara nga organet e bashkisë me konsultim publik gjatë një viti
- Numrin e përgjithshëm të komenteve dhe rekomandimeve të marra nga palët e interesuara
- Numrin e rekomandimeve dhe komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes
- Numrin e takimeve publike të organizuara

6.9 Iniciativa qytetare. Përfshin bërjen publike

- Mënyrës dhe formës së paraqitjes së iniciativës qytetare
- Procedurave të shqyrtimit dhe e miratimit të iniciativës qytetare
- Adresës postare/ elektronike për depozitimin e iniciativës qytetare
- Mënyrat dhe afatet e kthimit të përgjigjeve për mos miratimin e iniciativës qytetare



Mungon plotësisht informacioni për këtë seksion të Progamit të Transparenës, ndërsa ka një mundësi (elektronike) për të shprehur opinionin për buxhetin dhe për taksat.

7. Informacion tjetër

7.1 Bashkia në proceset e integritimit evropian

- Të dhënave për projektet, nismat dhe veprimtarisë e bashkisë në kuadrin e integritimit në BE"

7.2 Bashkia dhe shoqëria civile. Në tërësi të dhëna për grupet e interesit

- Të dhëna për OJF, përfaqësuesit e medias, biznesi
- Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme
- Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile
- Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile

7.3 Raporte, studime dhe vlerësime mbi zbatimin e Programit të transparencës.

- Raporte, studime dhe vlerësime mbi zbatimin e Programit të transparencës

7.4 Strukturat komunitare. Përfshin bërjen publike të:

- Të dhëna për strukturat komunitare në fshat
- Të dhëna për strukturat komunitare në qytet
- Detyrat, kompetencat dhe kompetencat e strukturave komunitare
- Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e këshillave komunitare



